



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/148

Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 146 dhe 147 e Qeverisë.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 43 të Ligjit për Ushqimin Nr. 03/L-016 dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Themelohet Bordi Drejtues i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në këtë përbërje:
 - 1.1. Shqipe Dema, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare
 - 1.2. Isuf Cikaqi, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar
 - 1.3. Besfort Metaj, Oda Ekonomike e Kosovës, anëtar
 - 1.4. Tahire Maloku-Gjergji, Ministria e Shëndetësisë, anëtare
 - 1.5. Naser Ramadani, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës anëtar
 - 1.6. Ali Gagica, Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorëve, anëtar
 - 1.7. Valdet Gjinovci, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar
2. Bordi Drejtues kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Ushqimin, nr. 03/L-016, dhe aktet nënligjore për zbatimin e ligjit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe institucionet tjera përgjegjëse.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit për Ushqimin nr. 03/L-016 si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Shkencor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me këtë përbërje:
 - 1.1. Selvete Krasniqi nga IKSHP/MSH - anëtare
 - 1.2. Bakir Kelmendi nga IBK/MBPZHR - anëtar
 - 1.3. Alush Musaj nga Fakulteti i Xehetarisë -anëtar
 - 1.4. Arben Mehmeti nga Fakulteti i Bujqësisë -anëtar
 - 1.5. Kurtesh Sherifi nga Fakulteti i Bujqësisë -anëtar.
2. Këshilli Shkencor do të ketë përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Ushqimin, nr. 03/L-016 si dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e këtij ligji.
3. Ngarkohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë, Nr. 8/147, i datës 05.10.2010.
2. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 pika 2 e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-218 si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

- 1 Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për reduktimin dhe ndarjen e €5.000.000,00 (pesë milionë) për komunat në veri të Kosovës.
 - 1.1. Për të realizuar pikën 1. të këtij vendimi prej €5.000.000,00 (pesë milionë), mjetet merren nga këto organizata buxhetore:
 - 1.1.1. €3.723.700 nga Ministria e Administrimit Publik, kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale,
 - 1.1.2. €562.500 nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, kategoria ekonomike, Shpenzimet Kapitale,
 - 1.1.3. €243.486 nga MEF-Dogana, kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale,
 - 1.1.4. €142.796 nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale,
 - 1.1.5. €72.547 nga Zyra Rregullative e Energjisë, kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale,
 - 1.1.6. €247.700 nga Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale,
 - 1.1.7. €7.271 nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale.

- 1.2. Mjetet nga pika 1.1. në shumë prej €5.0.00.000,00 ndahen në MEF - Departamenti i Thesarit për të ekzekutuar vendimin e Qeveris së Republikës së Kosovës, Nr. 02/142, datë 26.08.2010 (mjetet ndahen për komunat në veri të Kosovës).
2. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për reduktimin dhe ndarje të mjeteve buxhetore €435.000 për MAPL.
 - 2.1. €435.000,00 merren nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) në kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale. Projektet janë të specifikuara në shkresën e MFSK, dërguar MEF, më datën 07.10.2010.
 - 2.2. Mjetet nga pika 2.1 në shumë prej €435.000,00, ndahen në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale për implementim të vendimit të Qeverisë, me nr. 02/141, datë 25.08.2010.
3. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për reduktimin dhe ndarje të mjeteve buxhetore:
 - 3.1. Për të realizuar pikën 3 të këtij vendimi prej € 1.219.344,00 mjetet ndahen për këto organizata buxhetore:
 - 3.1.1. €520.074,00 ndahen për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e 30% të pagave të rregullta dhe 44 euro për dy muaj e fundit të vitit 2010.
 - 3.1.2. €500.000,00 ndahen për komunën e Gjilanit.
 - 3.1.3. €199.270,00 ndahen për MEF - Doganat e Kosovës, kategoria e Pagave dhe Mëditjeve
 - 3.1.4. Ministria e Shëndetësisë, për të realizuar pikën 3.2 të këtij Vendimi obligohet të dërgoj në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ndarjen e mjeteve sipas programeve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
 - 3.1.5. Komuna e Gjilanit për të realizuar pikën 3.3. të këtij Vendimi obligohet të dërgoj në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ndarjen e mjeteve sipas programeve në kategorinë ekonomike Mallra e shërbime dhe Subvencione e Transfere.
 - 3.2. Mjetet nga pika 3.1 në shumë prej €1,219,344 merren nga Rezervat e paparashikuara, kategoria ekonomike - Rezerva, kodi organizativ 232-131.
4. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për ndarje dhe reduktimin e €5,692,090 për KQZ-në sipas këtyre Organizatave buxhetore:
 - 4.1. Për të realizuar pikën 4 të këtij vendimi prej €5,692,090 mjetet merren nga këto Organizata buxhetore:
 - 4.1.1. €270,000 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Programi ' Administrata e Kuvendit' kategoria ekonomike, Shpenzime Kapitale
 - 4.1.2. €423,522 nga Zyra e Presidentit, nga kategoria e Shpenzimeve Kapitale.
 - 4.1.3. €2,000,000 nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave , programi Energjia - KEK, kategoria ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve.
 - 4.1.4. €900,000 nga Ministra e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, prej të cilave €400,000 nga programi Administrata Qendrore nga kategoria e Mallrave dhe

shërbimeve, si dhe €500,000 nga programi Universiteti i Prizrenit nga kategoria e Shpenzimeve Kapitale.

- 4.1.5. €1,150,000 nga Ministria e Punëve të Jashtëm, nga programi Ambasadat nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve.
 - 4.1.6. €20,000 Ministria e Integriteteve Evropiane, programi Administrata Qendrore nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.7. €65,000 nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.8. €197,806 nga Agjensioni Kosovari i Privatizimit, prej të cilave €43,894 nga programi i Privatizimit, €40,000 nga programi Likuidimi, €81,637 nga programi Administrata Qendrore, €5,765 nga programi Departamenti Ligjor, €13,789 nga programi Auditimi, €12,721 nga programi Kontrolli dhe Mbikëqyrja, të gjitha nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.9. €40,000 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.10. €44,562 Agjensioni Kosovari i Inteligjencës, prej të cilave €24,562 nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, si dhe €20,000 € nga shpenzimet kapitale.
 - 4.1.11. €21,200 nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.12. €60,000 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
 - 4.1.13. €500,000 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga programi "Gjykatat dhe Sekretariati" nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve
- 4.2 Mjetet nga pika 4 e këtij Vendimi në shumë prej €5,692,090 ndahen për Komisionin Qendror Zgjedhor. Sipas kategorive ekonomike €5,667,090 ndahen në kategorinë ekonomike, Mallra e Shërbime dhe €25,000 në Kategorinë ekonomike Shpenzimet komunale.
- 4.3 Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për ndarjen e shumës prej €1,000,000 për KQZ për zgjedhjet për pjesën veriore të Kosovës. MEF obligohet të reduktoj shumën prej €1,000,000 në Organizatat tjera buxhetore, sipas Nenit 3 të Ligjit të buxhetit Nr 03/L-218.
5. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktim dhe ndarje të mjeteve buxhetore:
- 5.1. €54,500 merren nga Agjencia Kosovare i Inteligjencës, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
 - 5.2. €54,500 ndahen për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
6. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktim dhe ndarje të mjeteve buxhetore:
- 6.1. €200,000 merren nga Ministria e Shëndetësisë, Programi "Programet tjera" kategoria ekonomike Mallra e Shërbime,

- 6.2. €200,000 ndahen për Ministrin e Administratës Publike, programi “Administrata Qendrore” shuma prej €100,000 dhe Programi “ Teknologjia Informative” shuma prej €100,000. Këto mjete shkojnë në kategorinë ekonomike Mallra e Shërbime.
7. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktim dhe ndarje të mjeteve buxhetore:
- 7.1. €50,000 merren nga Ministria e Administratës Publike, programi “Shërbimet e Administratës Civile”, kategoria ekonomike e Shpenzimeve Kapitale.
- 7.2. €50,000 ndahen për Zyrën e Kryeministrit, programi “Kabineti i Kryeministrit”, kodi 10700, në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime.
8. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për ndarjen e shumës prej €3,200,000 për Ministrin e Energjisë dhe Minierave, projekti LPTAP. MEF obligohet të reduktoj shumën prej €3,200,000 në Organizatat tjera buxhetore, sipas Nenit 3 të Ligjit të buxhetit Nr 03/L-218.
9. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe të gjitha Organizatat buxhetore/ Agjencionet që ndikohen nga ky Vendim.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim Thaçi

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet :

- të gjitha ministrive
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Jepet pëlqimi që Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës të emërtohet me emrin e Komandantit Legjendar të UÇK-ës "Adem Jashari".
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, Bordi i drejtorëve i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe Menaxhmenti i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/148

Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Jepet pëlqimi që Autostrada Vërmicë-Merdare të emërtohet me emrin e ish-presidentit të Kosovës, "Dr. Ibrahim Rugova".
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, si dhe Komisioni drejtues ndërmintor për ndërtimin e Autostradës Vërmicë - Merdare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të ligjit nr. 03/L- 139 për shpronësimin e pronës se paluajtshme, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme private në ngastrat kadastrale të paraqitura në tabelat të cilat janë pjesë e këtij vendimi për ndërtimin e autostradës Vërmicë-Merdare në segmentin e tretë (3) të zonave kadastrale Tërnje, Leshan, Reshtan dhe Suharekë deri te ngastra kadastrale 315, në komunën e Suharekës.
2. Miratohen ndryshimet e bëra në segmentin 1 dhe 2 Vërmicë -Novakë.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Kuvendi Komunal i Suharekës, ia dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
5. Pjesë e këtij vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit.
6. Nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit, Ministria për Ekonomi dhe Financa paguan plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar, të përcaktuar me këtë vendim.

7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronarë ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejt dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura këtij vendimi.
8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal i Suharekës.
9. Vendimi përfundimtar hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komunës së Suharekës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/148

Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Për sigurimin e mjeteve për financimin e 2 qendrave të Kompetencës për 4 muaj 2010 (shtator-dhjetor 2010) dhe atë:
 - 1.1. Qendra e Kompetencës në Malishevë dhe atë:
 - 1.1.1. Për Shtator - Dhjetor 2010 në shumë prej 48.354,12 euro,
 - 1.1.2. Mjete të barten në komunën e Malishevës, në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimit mesëm (94560), në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
 - 1.2. Qendra e Kompetencës në Skenderaj dhe atë:
 - 1.2.1 Për Shtator - Dhjetor 2010 në shumë prej 42.022,20 euro
 - 1.2.2 Mjete të barten në komunën e Skenderajt, në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimit mesëm (94860), në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
2. Shuma totale specifikohet në pajtim me tabelën e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

MALISHEVË				
Nr.	Punëtorët	Numri i punëtorëve	Paga për 1 muaj	Shator - Dhjetor 2010 (4 muaj)
1	Drejtor	1	315.00	1,260.00
2	zv. Drejtor	2	291.02	2,328.16
3	Mësimdhënës	38	263.83	40,102.16
4	Teknik/ Administrativ	6	-	4,663.70
TOTAL		47		48,354.12

SKENDERAJ				
Nr.	Punëtorët	Numri i punëtorëve	Paga për 1 muaj	Shator - Dhjetor 2010 (4 muaj)
1	Drejtor	1	315.00	1,260.00
2	zv. Drejtor	2	291.02	2,328.16
3	Mësimdhënës	32	263.83	33,770.24
4	Teknik/ Administrativ	6	-	4,663.70
TOTAL		41		42,022.20

3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/148
Datë: 05.11.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe duke u bazuar në rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Cilësisë të Agjencionit Kosovar për Akreditim, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2010, mori

V E N D I M

1. Akreditohet Universiteti i Prizrenit në nivel institucional.
2. Akreditohehen këto programe të studimit në Universitetin e Prizrenit:
 - 2.1. Administrim Biznesi (BA);
 - 2.2. Menaxhment Ndërkombëtar (BA);
 - 2.3. Teknologji Informative dhe Telekomunikim (BA);
 - 2.4. Dizajnim Softuerik (BA);
 - 2.5. Juridik (LLB) dhe
 - 2.6. Gjuhë Gjermane (BA).
3. Akreditimi është "ex ante" dhe zgjat një vit.
4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Agjencioni Kosovar për Akreditim dhe Universiteti i Prizrenit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë